



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr.690/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, Z. Blerim Dina – Referues dhe Z. Goran Milenković -Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “TETRONIKS LLC” Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik “IMPACT Sh.P.K.-Dega në Kosovë, Cimi@ELEKTRONIC Sh.P.K., Fushë Kosovë”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rregullimi i sistemit të zërimit, përkthimit dhe votimit elektronik në sallën e Kuvendit të Komunës së Malishevës”, me nr. të prokurimit: 62500-20-4269-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Kuvendi Komunal Malishevë”, me datën: 12.11.2020, mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “TETRONIKS LLC” Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rregullimi i sistemit të zerimit, përkthimit dhe votimit elektronik në sallën e Kuvendit të Komunës së Malishevës”, me nr. të prokurimit: 62500-20-4269-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Kuvendi Komunal Malishevë”.

**II. ANULOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i sistemit të zerimit, përkthimit dhe votimit elektronik në sallën e Kuvendit të Komunës së Malishevës”, me nr. të prokurimit: 62500-20-4269-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Kuvendi Komunal Malishevë” dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “TETRONIKS LLC” Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## AR SYETIM

Operatori ekonomik “TETRONIKS LLC” Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 16.09.2020 me nr. 690/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i Operatorëve Ekonomik “IMPACT Sh.P.K.-Dega në Kosovë, Cimi@ELEKTRONIC Sh.P.K., Fushë Kosovë”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Rregullimi i sistemit të zerimit, përkthimit dhe votimit elektronik në sallën e Kuvendit të Komunës së Malishevës”, me nr. të prokurimit: 62500-20-4269-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Kuvendi Komunal Malishevë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 28 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 09.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 19.10.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sa i përket Vlerësimit të Pretendimeve të OE ankuesit:

Eksperti Shqyrtues pas verifikimit dhe vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit, dhe pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me specifikat teknike janë të bazuara. Deri të ky përfundim, eksperti shqyrtues ka ardhur, pas analizimit të dosjes së tenderit, specifikave teknike të cilat janë afruar nga modelet përkatëse, dhe hulumtimeve të pavarura që janë bërë për këto modele, dhe konstaton që OE i shpallur fitues nuk i plotëson të gjitha kriteret teknike të kërkuara nga AK sipas specifikave të dosjes së tenderit. Për më tepër, do të jepen sqarime plotësuese si me poshtë.

Pretendimi ankimor – 1: OE ankues pretendon që: “Në dosje të tenderit, Seksioni II Fleta e të dhënave të



Tenderit (FTD) është kërkuar tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, “4. Lista e produkteve me broshurat ose katalog me specifikat teknike, e. Lista e produkteve me broshurat ose katalog me specifikat teknike, e nënshkruar dhe vulosur nga OE”, OE i përzgjedhur për kontratë ka dorëzuar një listë të produkteve të ofertuara mirëpo që nuk përfshihen të gjitha paisjet sipas kërkesës tuaj në specifikimet teknike. Në këtë listë mungojnë modelet për: Aplikacioni softuerik për votim elektronik dhe menaxhim të sistemit {pako}, TV 40”, TV 50”, PC desktop, Kabllo vazhdues të sistemit të mikrofonave. Sipas RrUOPP udhëzohet se si duhet të veprojnë AK në rast se OE nuk dorëzon specifikacionin teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu, AK sipas nenit 28 të LPP-së, duhet të refuzoj tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm”.

Ne lidhje me pretendimet e OE ankues për kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, Eksperti Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me specifikat teknike janë të bazuara. Eksperti Shqyrtues, e ka krahasuar dosjen e tenderit, Seksioni II Fleta e të dhënave të Tenderit (FTD) me listën e produkteve të ofertuara nga OE i përzgjedhur për kontratë dhe është konfirmuar pretendimi, ku mungojnë modelet për: Aplikacioni softuerik për votim elektronik dhe menaxhim të sistemit {pako}, TV 40”, TV 50”, PC desktop, Kabllo vazhdues të sistemit të mikrofonave. Andaj sipas dokumenteve të prezantuara, nuk është plotësuar kërkesa e AK-së, kërkesën e specifikuar në dosjen e tenderit, rrjedhimisht pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor – 2: OE ankues pretendon që: “Në dosje të tenderit, Seksioni II Fleta e të dhënave të Tenderit (FTD) është kërkuar tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, “6. Të ofrohet përshkrim i sistemit të punës të komplet ndërlidhëses së paisjeve dhe aplikacioneve., g. Plan i detajuar i punës së sistemit. Kopje. ”, përderisa OE i përzgjedhur për kontratë nuk ka dorëzuar një përshkrim apo plan të detajuar që përshkruan ndërlidhjen e sistemit por ka dorëzuar një deklaratë 1 faqe “Plani i instalimi të paisjeve” që përshkruan shkurtimisht në 5 pika veprimet e instalimit”.

Ne lidhje me pretendimet e OE ankues për Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Eksperti Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me specifikat teknike janë pjesërisht të bazuara.

Pretendimi ankimor – 3: OE ankues pretendon që në “Njësinë qendrore dhe digjitale e sistemit (Pozicioni nr.1). Është ofertuar nga OE modeli VIS-DCP2000-D, mirëpo ky model nuk përmbush kërkesat teknike minimale të kërkuara nga ju në Aneksin 1. Në kërkesën teknike “Të mundësojë delegatëve aktivizimin e mikrofonave me zë (sipas ndjeshmërisë dhe nivelit të zërit)” modeli i ofruar nuk e mundëson një funksion të tillë pasi që në katalogun e prodhuesit për këtë model, thuhet se ky model përkrah këto mënyra diskutimi:

i. OPEN —të gjithë mikrofonat e lejuar të jenë aktiv

- ii. OVERRIDE—*i pari aktiv, tjetri deaktiv*
- iii. FREE — *aktivizohen mikrofona deri në maksimumin e lejuar*
- iv. APPLY — *parashtron kërkesë për të folur*


Në dokumentacionin e dorëzuar nga OE nuk dëshmohet se posedon funksionin e aktivizimit me zë (Voice) ashtu siq është kërkuar në Aneks”.

Në lidhje me pretendimet e OE ankues për njësinë qendrore dhe digjitale e sistemit, ku nga OE fitues është ofertuar modeli VIS-DCP2000-D, Eksperti Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit, dhe pas hulumtimeve të bëra për këtë model nga përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm<sup>1</sup> konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara.

Oferta e OE fitues:

### CLEACON VIS-DCP2000-D

Full Digital Networked DSP Conference Processor



"OPEN" Free for all, limited by the active units setting

by controller , "OVERRIDE" First in First

out , "VOICE" Can activate MIC by detecting

sound without press button, "APPLY" To apply then  
to speak

Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.

<sup>1</sup> Për më tepër, shif: <http://www.vissonic.com/product/100.html>, <https://addiaudiovisual.com/en/buy/conference-system-controller-vissonic-vis-dcp2000-d/>, <https://digikal.gr/en/products/public-address/conference-systems/vissonic-vis-dcp2000-d>, <http://www.audioconferencemicrophone.com/sale-11422250-vissonic-full-digital-networked-dsp-conference-processor-microphone-array-system-vis-dcp2000-r.html>.



## Functions

- Compliance with IEC 60914, GBT 15381-94
- With VIS-CNB digital power box, it can expand to 5200 discussion units
- Support "Hand-in-Hand-Loop-Network" connection and the system assigned to each unit independently ID to avoid duplicate ID conflict
- Both wired/wireless discussion units can connect to the controller, fast and easily to adding delegate of meetings
- Wireless unit supports up to 8 microphones active simultaneously, anti-interference ability is stronger than ever, compliance with IEEE 802.11n standard Wi-Fi both for 2.4GHz and 5GHz
- 2 channel audio input, XLR or RCA type, for local input or remote video-conferencing input
- MAX 8 channel audio output, XLR, RCA or Phoenix type, to connect language translation system or output to different zones
- TCP/IP connection between controller and PC
- RS232 to send the PELCO/VISCA protocol to realize camera auto-tracking function.
- Hot-swap for any system unit, and the controller has auto-recovery function
- Wide range of voltage from 110V~220VAC
- Without using PC software, our conference controller still owns following settings:
  - Limit on the number of speaking persons: By Setting the number of active units at the same time

**Pretendimi ankimor – 4:** OE ankues pretendon që në: “Njësinë qendrore digjitale me rreze infra të kuqe (pozicioni nr.2), është kërkuar *“Të ketë së paku një emitues me rreze infra të kuqe, të integruar në pjesën e përparme të njësisë, për të mundësuar teknikun monitorim të kanaleve nga dhoma e paisjeve”*, përderisa modeli i ofertuar VIS-VLI700A nuk posedon një të tillë dhe kjo paisje nuk i mundëson operatorit apo stafit teknik të bëjë monitorim apo kontroll teknik nga dhoma e paisjeve, e cila është shumë e rëndësishme gjatë seancave të kujdeset për mbarrëvajtjen e seancës.

• Është kërkuar *“USB port për ruajtjen e shënimeve dhe instalimin e softuerit (upgrade)”* përderisa VIS-VLI700A nuk posedon port USB që mundëson ruajtjen e shënimeve apo përditësim të softuerit të pajisjes.

• Është kërkuar *“Të ketë së paku një port Ø 3.5 mm për lidhje të kufjeve monitoruese”* ndërsa ky model nuk posedon port të tillë dhe nuk i mundëson operatorit apo stafit teknik të bëjë monitorim apo kontroll teknik nga dhoma e paisjeve, e cila është shumë e rëndësishme gjatë seancave të kujdeset për mbarrëvajtjen e seancës”.

Në lidhje me pretendimet e OE ankues për njësia qendrore dhe digjitale e sistemit, ku nga OE fitues është ofertuar modeli VIS-VLI700A, Eksperti Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit, dhe pas hulumtimeve të bëra për këtë model nga përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm<sup>2</sup>, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara.

<sup>2</sup> Për më tepër, shif: <https://vissonic.en.made-in-china.com/product/tCkxiAPjZVWd/China-Vissonic-Conference-System-Vis-VLI700A-Series-Digital-Infrared-Wireless-Transmitter.html>,  
<https://www.iseurope.org/epr/0015700002F9eg7AAB1572511570.pdf>  
<http://www.vissonic.com/product/130.html>

Oferta e OE fitues:

## VIS-VLI700A Digital Infrared Transmitter

The transmitter is the central element in the language distribution system. It accepts analogue or digital input, modulates these signals onto carrier waves and transmits these carrier waves to radiators located in the room.



### Technical Specifications

#### System Specifications

Modulation.....	DQPSK, according to IEC 61603-7
Modulation frequency.....	2 to 8 MHz Carriers 0 to 5:2 to 6 MHz, according to IEC 61603-7
Frequency response.....	20 Hz to 10 kHz (-3dB) at standard quality; 20 Hz to 20 kHz (-3dB) at perfect quality
THD at 1 kHz.....	<0.05%
Isolation.....	>80 dB
Dynamic range.....	>90 dB
Weighted SNR.....	>85 dBA

#### Electrical

Unbalanced audio inputs.....	-12 dBV to +12 dBV nominal
------------------------------	----------------------------

Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.

Pretendimi ankimor – 5: OE ankues pretendon që në “Radiatori digjital me rreze infra të kuqe. Është kërkuar “Të ketë shumëkanalësh, së paku 32 kanale shpërndarëse”, ndërsa modeli i ofertuar VIS-VLI701A nuk posedon 32 kanale dhe nuk është konform kërkesës tuaj”.

Ne lidhje me pretendimet e OE ankues për njësinë qendrore dhe digjitale e sistemit, ku nga OE fitues është ofertuar modeli VIS-VLI701A, Eksperti Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit, dhe pas hulumtimeve të bëra për këtë model nga përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm<sup>3</sup>, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara.

<sup>3</sup> Për më tepër, shif: <http://www.vissonic.com/product/131.html>, <https://vissonic.en.made-in-china.com/product/VXDxalvBsnAR/China-Vissonic-Digital-Infrared-Radiator-Simultaneous-Interpretation-System.html>



## Oferta e OE fitues:

### VIS-VLI701A Digital Infrared Radiator

These radiators are used to distribute infrared signals throughout the conference space, enabling delegates to listen to the proceedings by means of personal pocket receivers.



### Technical Specifications

#### Electrical and optical

Modulation.....DQPSK, according to IEC61603-7

Modulation frequency

Carriers 0 to 5.....2 to 6 MHz, according to IEC 61603-7

Carriers 6 to 7.....Up to 8 MHz

Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.

Pretendimi ankimor – 6: OE ankues pretendon që në “Njësia digjitale e kryesuesit me mundësi votimi dhe selektor të kanaleve dhe Njësia digjitale e delegatit me mundësi votimi dhe selektor të kanaleve (pozicioni nr.4 dhe 5).

- a. Në listën e produkteve të OE, pozicioni nr.4. është ofertuar modeli VIS- DVCIC-T dhe poz.nr.5 modeli VIS-DVDIC-T, këto dy modele nuk plotësojnë kërkesat minimale teknike të kërkuara nga ju.
- b. Në kërkesën tuaj *“Të jetë i pajisur me filtër të integruar të frekuencave për të ndërprerë frekuencat e ulta nga audio sinjali nëse është e nevojshme”* modeli i ofruar nga OE nuk e posedon fare një filtër të tillë.
- c. *“Të jetë i pajisur me lexues të integruar të kartelës identifikuese për delegatë”*. Nuk ka fare slot për IC (ID) kartelë, në këtë model nuk mund të bëhet identifikimi i prezencës së delegatëve në sallë para fillimit të seancës për votim elektronik. Duke marrë parasysh kërkesën tuaj se posedimi i slot-it për identifikim të delegatit para nisjes së çdo seance të asamblesë komunale është shumë i rëndësishëm në shumë aspekte, siç janë: konfirmimi i prezencës së delegatit, kuorumi, të dhënat personale vendosen në ID kartelë, rezultati individual i votimit pas përmbylljes së seancës së votimit, arkivimi digjital, atëherë ofrimi i një modeli që nuk posedon një funksion të tillë do duhej konsideruar si të papërgjegjshme dhe jo konform kërkesës teknike. Me këto modele të ofertuara, delegatët në sallë mund të votojnë pa u identifikuar paraprakisht në sistemin e prezencës me kartelë gjë që është në kundërshtim me kërkesën teknike.
- d. *“Të jetë i pajisur me selektor të kanaleve, butona për zgjedhjen e kanaleve të përkthimit dhe të dhënat e kanalit të paraqiten në displej”*. Nuk ka buton të dedikuar për selektimin e kanaleve të përkthimit, por butonin nr.2 dhe nr.3 që janë dedikuar për votim mund të

përdoren për selektim të kanaleve në rastin kur nuk lansohet procedura e votimit elektronik, në të kundërtën këta butona përdoren për votim. Gjatë procedurës së votimit këta butona nuk mund të përdoren për selektimin e kanalit të përkthimit.

- e. *“Të ketë buton për rregullimin e nivelit të zërit (volumit) në rast të kyçjes së kufjeve”*. Nuk ka buton të dedikuar për rregullimin e nivelit të zërit, por butonin nr.4 dhe nr.5 që janë dedikuar për votim mund të përdoren për rregullim të nivelit të zërit në rastin kur nuk lansohet procedura e votimit elektronik në të kundërtën këta buton përdoren për votim. Gjatë seancës së votimit këta butona nuk mund të përdoren për rregullim të nivelit të zërit”.

Ne lidhje me pretendimet e OE ankues për njësinë digjitale të kryesuesit me mundësi votimi dhe selektor të kanaleve dhe Njësinë digjitale të delegatit me mundësi votimi dhe selektor të kanaleve ku nga OE fitues janë ofertuar modelet VIS- DVCIC-T dhe modeli VIS-DVDIC-T, Eksperti Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit, dhe pas hulumtimeve të bëra për këtë model nga përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm<sup>4</sup>, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara.

Oferta e OE fitues janë modelet VIS- DVCIC-T dhe VIS-DVDIC-T:

## CLEACON VIS-DIC-T/ VIS-DID-T

CAT5 Wired Digital Interpretation Chairman/Delegate Unit



<sup>4</sup> Për më tepër, shif: <https://www.google.com/search?q=VIS-+DVCIC->

[T&tbm=isch&source=iu&ictx=1&fir=pSITFvVZRwkFZM%252C6eI8D7dEvhjdsM%252C\\_&vet=1&usg=AI4\\_-kRTWtZa79pODWyJY0xhFRSbQsZTFg&sa=X&ved=2ahUKEwjLrZWbhL\\_sAhUgTxUIHZxzCdGQ9QF6BAgDEAg#imgsrc=nOsFZImJSGJZZM&imgdii=VMRI\\_S1iEf1hqM](https://www.google.com/search?q=VIS-+DVCIC-T&tbm=isch&source=iu&ictx=1&fir=pSITFvVZRwkFZM%252C6eI8D7dEvhjdsM%252C_&vet=1&usg=AI4_-kRTWtZa79pODWyJY0xhFRSbQsZTFg&sa=X&ved=2ahUKEwjLrZWbhL_sAhUgTxUIHZxzCdGQ9QF6BAgDEAg#imgsrc=nOsFZImJSGJZZM&imgdii=VMRI_S1iEf1hqM)



## Functions

- Compliance with IEC 60914, GBT 15381-94
- The unique AUDIO-LINK digital ring network technology achieve full-digital signal transmission and processing, completely avoid the RF interference from cell phone or similar devices.
- One CAT5e cable to transmit 64 channel audio and other signals
- High fidelity sound by zero loss audio transmit



Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që këto produkte nuk i plotësojnë kërkesat minimale teknike të AK-së.

**Pretendimi ankimor – 7:** OE ankues pretendon që në: “Njësinë digjitale e delegatit me selektor të kanaleve (pa mundësi votimi), është kërkuar *“Të jetë i paisur me filtër të integruar të frekuencave për të ndërprerë frekuencat e ulta nga audio sinjali nëse është e nevojshme”* modeli i ofruar VIS-DID-T nuk e posedon fare një filtër të tillë”.

Ne lidhje me pretendimet e OE ankues për njësinë qendrore dhe digjitale e sistemit, ku nga OE fitues është ofertuar modeli VIS-DID-T, Eksperti Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit, dhe pas hulumtimeve të bëra për këtë model nga përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm<sup>5</sup>, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara.

Oferta e OE fitues:

<sup>5</sup> Për me tepër, shif: <https://addiaudiovisual.com/en/buy/delegated-microphone-module-vissonic-vis-did-t/>, <http://www.vissonic.com/product/106.html>



### Features

- Stylish, low profile design with touchable interface
- Standard CAT5e and RJ45 connectors are used in CLEACON series to provide more convenient on project and maintenance.
- The connection of MIC units are either hiding underneath or from the rear of the unit, makes it convenient for different request of installation.
- Five keys voting function
- Support interpretation function with 64 channels selector which can display the language and channel number (Insert the earphone and the channel selector is active)
- OLED screen, providing excellent brightness, contrast, wide viewing angle but low power consumption
- Internal high fidelity loudspeaker
- Head-set interface in both sides with volume adjust
- Line-in interface which allows microphone or other line-in device like cell phone, laptop to pass audio through to perform teleconference
- The unique AUDIO-LINK digital ring network technology achieve full-digital signal transmission and processing, completely avoid the RF interference from cell phone or similar devices.
- Strong system robust by the "Hand-in-Hand-Loop-Network" connection method.
- Timer on display to set certain time for each delegate to speak, will remind user or close the MIC automatically
- All units can be configured as Chairman or Delegate unit through software settings based on model DVC-T.

### Functions

- Compliance with IEC 60914, GBT 15381-94
- The unique AUDIO-LINK digital ring network technology achieve full-digital signal transmission and processing, completely avoid the RF interference from cell phone or similar devices.
- One CAT5e cable to transmit 64 channel audio and other signals

Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.

**Pretendimi ankimor – 8:** OE ankues pretendon që në: “Njësinë digjitale e përkthyesit simultan sipas standardit IEC 60914, ISO 2603 dhe ISO 4043, modeli i ofertuar VIS-INT64 nuk plotëson kërkesat konform standardeve të kërkuara. Të ketë butonin dhe funksionin përsëritës (repeat) dhe të ketë funksionin e ngadalësimit (slow alert) që paralajmëron folësin të flasë më ngadalë në rast së përkthyesi nuk mund të përcjell me përkthim”.

Ne lidhje me pretendimet e OE ankues për njësinë digjitale e përkthyesit simultan sipas standardit IEC 60914, ISO 2603 dhe ISO 4043, ku nga OE fitues është ofertuar modeli VIS-INT64, Eksperti Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit,



dhe pas hulumtimeve të bëra për këtë model nga përshkrimet e bëra nga prodhuesi<sup>6</sup>, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara.

Oferta e OE fitues:

### **VIS-INT64 64 Channels Interpreter Desk**

VIS-INT64 is 64 channels interpreter desk that enables direct and relay interpretation available in 63+1 languages to provide an easy and relax time during interpretation work.



Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së

Pretendimi ankimor – 9: OE ankues pretendon që në: “Kufjet për njësitë e delegatëve është kërkuar *“Frekuenca e reagimit të jetë nga 20Hz deri 20kHz”* ndërsa modeli i ofertuar VIS-HPD mundëson prej 80Hz deri 2kHz, dmth nuk është në kuadër të brezit frekuencor të kërkuar”.

Ne lidhje me pretendimet e OE ankues për Kufjet për njësitë e delegatëve, ku nga OE fitues është ofertuar modeli i ofertuar VIS-HPD, Eksperti Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit, dhe pas hulumtimeve të bëra për këtë model nga përshkrimet e bëra nga prodhuesi<sup>7</sup>, konsideron se

<sup>6</sup> Për me tepër, shif: <http://www.vissonic.com/uploadfiles/201906081532532077.pdf>

<sup>7</sup> Për me tepër, shif: <http://www.vissonic.com/news/54.html>

### Controls and Indicators

- Microphone mounted on a flexible stem, complete with a light ring
- Headphone volume controls knob
- Speaker volume controls knob
- A-B channel selector key for the quickly select the Input(interpreter hearing) language
- IN Select Knob with LCD indicating channel for fast switching between the original floor language and the channel set on the channel selector
- OUT Select Knob with LCD indicating channel for fast switching between the output channels
- Microphone activating key with LED status indicator
- Microphone 'COUGH' key to mute the MIC while pressing
- FLOOR-RELAY key to fast switch between floor language and relay language
- Call key (voice) to provide two-way communication between interpreter and operator

Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së

Pretendimi ankimor – 9: OE ankues pretendon që në: “Kufjet për njësitë e delegatëve është kërkuar *“Frekuenca e reagimit të jetë nga 20Hz deri 20kHz”* ndërsa modeli i ofertuar VIS-HPD mundëson prej 80Hz deri 2kHz, dmth nuk është në kuadër të brezit frekuencor të kërkuar”.

Ne lidhje me pretendimet e OE ankues për Kufjet për njësitë e delegatëve, ku nga OE fitues është ofertuar modeli i ofertuar VIS-HPD, Eksperti Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit, dhe pas hulumtimeve të bëra për këtë model nga përshkrimet e bëra nga prodhuesi<sup>8</sup>, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara.

Oferta e OE fitues:

---

<sup>8</sup> Për më tepër, shif: <http://www.vissonic.com/news/54.html>





VIS-HPD head phone for delegates

### ***Technical Parameters***

Unit Interface Dual Channel Plug  
 Frequency Response 80Hz – 2KHz  
 Sensitivity 90dB  
 Signal to noise ratio > 80dB  
 Distortion < 0.1dB  
 Impedance 32  $\Omega$   
 Dynamic range > 85 dB  
 Output power 100mW

Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.

Pretendimi ankimor – 10: OE ankues pretendon që në: “Njësia digjitale e përforcimit të zërit Në listën e produkteve të OE është ofruar modeli VIS-CDA-4, amplifikator i fuqisë së zërit dhe nuk plotëson kërkesat minimale teknike të kërkuara nga AK sipas specifikave teknike të dosjes së tenderit, .... të jetë i prodhuar sipas standardit IEC 61603-7 dhe IEC60914; të ketë USB port për të mundësuar regjistrimin e zërit, të ketë ekran për kontroll të regjimit të punës dhe konfiguracionit, të ketë përkrahje për së paku dy mikrofona ajror, të ketë të integruar BNC konektor për lidhje me pajisjet infrared dhe të jetë kompatibil me njësine qendrore të mikrofona konferencial, Të ketë së paku dy audio linja në hyrje dhe dalje dhe një RS232 port për lidhje me sistem të kontrollit”.

Ne lidhje me pretendimet e OE ankues për njësia digjitale e përforcimit të zërit, në listën e produkteve të OE është ofertuar modeli VIS-CDA-4, amplifikator i fuqisë së zërit. Eksperti Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit, dhe pas hulumtimeve të bëra për këtë model nga përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara.

Oferta e OE fitues:

### **VIS-CDA-4 power amplifier**



### Parameters:

Rated output power: 8Ω stereo 300W × 4  
Rated output power: 4Ω stereo 500W × 4  
Rated bridge output power: 8Ω bridged 900WX2 Power requirements: AC220V  
Structure: 1U metal chassis design  
Number of channels: 4CH  
Harmonic distortion (1kHz, 8ohms): <0.1%  
Frequency response: 15Hz-20kHz: ± 0.1dB (1W / 8Ω)  
Input impedance: balanced 20K ohm unbalanced 10K Ohm sensitivity: 0.775V  
Signal to noise ratio: ≥100dB  
Damping coefficient: (350: 1, 1Khz 8ohms) Conversion rate: 28V / US  
Output stage: Class-D  
LED indicator: power / signal / distortion / clipping  
Input connector: balanced male and female XLR  
Output connector: SPEAKON  
Cooling system: dual variable speed fans, exhaust air from front to back  
Protection function: overheat, short circuit, DC output  
Dimensions: 482 × 295 × 44mm

Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.

Pretendimi ankimor – 11: OE ankues pretendon që në: “Altoparlantë muri në formë kolone është kërkuar “*Të ketë Pension konstant 100/70V*”, modeli i ofertuar VIS-SPK-C4.3 nuk plotëson një kërkesë të tillë.

Në lidhje me pretendimet e OE ankues për Altoparlantë muri në formë kolone është kërkuar “*Të ketë Pension konstant 100/70V*”, në listën e produkteve të OE është ofertuar modeli VIS-SPK-C4.3. Eksperti Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit, dhe pas hulumtimeve të bëra për këtë model nga përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara.

Oferta e OE fitues:

### VIS-SPK-C4.3



### Parameters:

Frequency response (±3dB): 135Hz-20kHz  
Unit: 4×3"full/19 mm(VC)  
Nominal impedance: 8 Ohm Power: 80W(AES), 320W(PEAK)  
Sensitivity: 93dB/w/m  
Maximum sound pressure level: 118dB  
Covering angle: H100°× V30°  
Socket: 2×NL4 speakon  
Product size (W×D×H): 124×155×375mm  
Net weight: 4.1kg



Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.

Pretendimi ankimor – 11: OE ankues pretendon që në “sipas kërkesës në specifikimet teknike të kërkuara nga AK, OE i përzgjedhur për kontratë nuk ka dorëzuar specifikacion teknik, model, broshurë apo katalog dhe nuk janë paraqitur fare në listën e produkteve të ofertuara produktet tjera siç janë: Aplikacioni softuerik për votim elektronik dhe menaxhim të sistemit (pako), TV 40”, TV 50”, PC dekstop, Kabllo vazhdues të sistemit të mikrofonave”.

Ne lidhje me pretendimet e OE ankues, Eksperti Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me specifikimet teknike janë të bazuara. Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, ku mungon një broshurë apo katalogë të cekura në pretendimin ankimor të OE. Andaj OE i rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesat specifike të dosjes së tenderit.

Eksperti Shqyrtues sqaron se në nga çka u tha më lartë, konsideron se ky Aktivitet i Prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim, ku AK në bazë të kompetencave të vazhdojë procesin e rivlerësimit konform dispozitave LPP-së.

#### Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të jetë pjesërisht e bazuar dhe se ky Aktivitet i Prokurimit të kthehet në rivlerësim, ku AK në bazë të kompetencave të tyre të vazhdojë procesin e rivlerësimit konform dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka njoftuar OSHP-në se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datën 20.10.2020, me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave,

raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "TETRONIKS LLC" Prishtinë, se në dosje të tenderit, Seksioni II Fleta e të dhënave të Tenderit (FTD) është kërkuar tek: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, "4. Lista e produkteve me broshurat ose katalog me specifikat teknike, e. Lista e produkteve me broshurat ose katalog me specifikat teknike, e nënshkruar dhe vulosur nga OE", OE i përzgjedhur për kontratë ka dorëzuar një listë të produkteve të ofertuara mirëpo që nuk përfshihen të gjitha pajisjet sipas kërkesës tuaj në specifikimet teknike. Në këtë listë mungojnë modelet për: Aplikacioni softuerik për votim elektronik dhe menaxhim të sistemit {pako}, TV 40", TV 50", PC desktop, Kabllo vazhdues të sistemit të mikrofonave. Sipas RrUOPP udhëzohet se si duhet të veproj AK në rast se OE nuk dorëzon specifikacionin teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu, AK sipas nenit 28 të LPP-së, duhet të refuzoj tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm".

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimet e OE ankues për kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me specifikat teknike janë të bazuara. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas krahasimit të dosjes së tenderit, Seksioni II Fleta e të dhënave të Tenderit (FTD) me listën e produkteve të ofertuara nga OE i përzgjedhur për kontratë dhe është konfirmuar pretendimi, ku mungojnë modelet për: Aplikacioni softuerik për votim elektronik dhe menaxhim të sistemit {pako}, TV 40", TV 50", PC dekstop, Kabllo vazhdues të sistemit të mikrofonave. Andaj sipas dokumenteve të prezantuara, nuk është plotësuar kërkesa e AK-së, kërkesën e specifikuar në dosjen e tenderit, rrjedhimisht pretendimi ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues, se në dosje të tenderit, Seksioni II Fleta e të dhënave të Tenderit (FTD) është kërkuar tek: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, "6.Të ofrohet përshkrim i sistemit të punës të komplet ndërlidhëjes së paisjeve dhe aplikacioneve., g.Plan i detajuar i punës se sistemit.Kopje. ", përderisa OE i përzgjedhur për kontratë nuk ka dorëzuar një përshkrim apo plan të detajur që përshkruan ndërlidhjen e sistemit por ka dorëzuar një deklaratë 1 faqe "Plani i instalimi të paisjeve" që përshkruan shkurtimisht në 5 pika veprimet e instalimit".

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimet e OE ankues për kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me specifikat teknike janë pjesërisht të bazuara.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues, se në "Njësinë qendrore dhe digjitale e sistemit (Pozicioni nr.1). Është ofertuar nga OE modeli VIS-DCP2000-D, mirëpo ky model nuk përmbush kërkesat teknike minimale të kërkuara nga ju në Aneksin 1. Në kërkesën teknike "Të mundësoj delegatëve aktivizimin e mikrofonave me zë



(sipas ndjeshmërisë dhe nivelit të zërit)” modeli i ofruar nuk e mundëson një funksion të tillë pasi që në katalogun e prodhuesit për këtë model, thuhet se ky model përkrah këto mënyra diskutimi:

- v. OPEN — *të gjithë mikrofonat e lejuar të jenë aktiv*
- vi. OVERRIDE — *i pari aktiv, tjetri deaktiv*
- vii. FREE — *aktivizohen mikrofonat deri në maksimumin e lejuar*
- viii. APPLY — *parashtron kërkesë për të folur*

Në dokumentacionin e dorëzuar nga OE nuk dëshmohet se posedon funksionin e aktivizimit me zë (Voice) ashtu siq është kërkuar në Aneks”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimet e OE ankues për njësinë qendrore dhe digjitale e sistemit, ku nga OE fitues është ofertuar modeli VIS-DCP2000-D, ku pas hulumtimeve të bëra nga eksperti për këtë model si në përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara. Lidhur me këtë pretendim, Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti i ka bashkangjitur modelin me fotografi të produktit të OE të rekomanduar, dhe bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues, ku pretendon që në: “Njësinë qendrore digjitale me rreze infra të kuqe (pozicioni nr.2), është kërkuar *“Të ketë së paku një emitues me rreze infra të kuqe, të integruar në pjesën e përparme të njësisë, për të mundësuar teknikut monitorim të kanaleve nga dhoma e paisjeve”,* përderisa modeli i ofertuar VIS-VLI700A nuk posedon një të tillë dhe kjo paisje nuk i mundëson operatorit apo stafit teknik të bëjë monitorim apo kontroll teknik nga dhoma e paisjeve, e cila është shumë e rëndësishme gjatë seancave të kujdeset për mbarëvajtjen e seancës. Është kërkuar *“USB port për ruajtjen e shënimeve dhe instalimin e softuerit (upgrade)”* përderisa VIS-VLI700A nuk posedon port USB që mundëson ruajtjen e shënimeve apo përditësim të softuerit të pajisjes. Është kërkuar *“Të ketë së paku një port Ø 3.5 mm për lidhje të kufjeve monitoruese”* ndërsa ky model nuk posedon port të tillë dhe nuk i mundëson operatorit apo stafit teknik të bëjë monitorim apo kontroll teknik nga dhoma e paisjeve, e cila është shumë e rëndësishme gjatë seancave të kujdeset për mbarëvajtjen e seancës”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimet e OE ankues për njësi qendrore dhe digjitale e sistemit, ku nga OE fitues është ofertuar modeli VIS-VLI700A, ku pas hulumtimeve të bëra nga eksperti për këtë model dhe në përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara. Për më tepër, Paneli Shqyrtues sqaron se në raportin e ekspertit është bashkangjitur fotografia me të dhënat teknike për produktin e ofruar “VIS-VLI700A Digital Infrared Transmitter” nga OE i rekomanduar. Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale



teknike të AK-së.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues, ku pretendon që në “Radiator digjital me rreze infra të kuqe. Është kërkuar *“Të ketë shumëkanalësh, së paku 32 kanale shpërndarëse”*, ndërsa modeli i ofertuar VIS-VLI701A nuk posedon 32 kanale dhe nuk është konform kërkesës tuaj”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimet e OE ankues për njësinë qendrore dhe digjitale e sistemit, ku nga OE fitues është ofertuar modeli VIS-VLI701A, Paneli Shqyrtues sqaron se pas hulumtimeve të bëra nga eksperti për këtë model në përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara. Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se në raportin e ekspertit është bashkangjitur fotografia me të dhënat teknike për produktin e ofruar “VIS-VLI701A nga OE i rekomanduar. Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, ku pretendon që në “Njësia digjitale e kryesuesit me mundësi votimi dhe selektor të kanaleve dhe Njësia digjitale e delegatit me mundësi votimi dhe selektor të kanaleve (pozicioni nr.4 dhe 5).

- f. Në listën e produkteve të OE, pozicioni nr.4. është ofertuar modeli VIS- DVCIC-T dhe poz.nr.5 modeli VIS-DVDIC-T, këto dy modele nuk plotësojnë kërkesat minimale teknike të kërkuara nga ju.
- g. Në kërkesën tuaj *“Të jetë i pajisur me filtër të integruar të frekuencave për të ndërprerë frekuencat e ulta nga audio sinjali nëse është e nevojshme”* modeli i ofruar nga OE nuk e posedon fare një filtër të tillë.
- h. *“Të jetë i pajisur me lexues të integruar të kartelës identifikuese për delegatë”*. Nuk ka fare slot për IC (ID) kartelë, në këtë model nuk mund të bëhet identifikimi i prezencës së delegatëve në sallë para fillimit të seancës për votim elektronik. Duke marrë parasysh kërkesën tuaj se posedimi i slot-it për identifikim të delegatit para nisjes së çdo seance të asamblesë komunale është shumë i rëndësishëm në shumë aspekte, siç janë: konfirmimi i prezencës së delegatit, kuorumi, të dhënat personale vendosen në ID kartelë, rezultati individual i votimit pas përmbylljes së seancës së votimit, arkivimi digjital, atëherë ofrimi i një modeli që nuk posedon një funksion të tillë do duhej konsideruar si të papërgjegjshme dhe jo konform kërkesës teknike. Me këto modele të ofertuara, delegatët në sallë mund të votojnë pa u identifikuar paraprakisht në sistemin e prezencës me kartelë gjë që është në kundërshtim me kërkesën teknike.

- i. *“Të jetë i paisur me selektor të kanaleve, butona për zgjedhjen e kanaleve të përkthimit dhe të dhënat e kanalit të paraqiten në displej”*. Nuk ka buton të dedikuar për selektimin e kanaleve të përkthimit, por butonin nr.2 dhe nr.3 që janë dedikuar për votim mund të përdoren për selektim të kanaleve në rastin kur nuk lansohet procedura e votimit elektronik, në të kundërtën këta butona përdoren për votim. Gjatë procedurës së votimit këta butona nuk mund të përdoren për selektimin e kanalit të përkthimit.
- j. *“Të ketë buton për rregullimin e nivelit të zërit (volumit) në rast të kyçjes së kufjeve”*. Nuk ka buton të dedikuar për rregullimin e nivelit të zërit, por butonin nr.4 dhe nr.5 që janë dedikuar për votim mund të përdoren për rregullim të nivelit të zërit në rastin kur nuk lansohet procedura e votimit elektronik në të kundërtën këta buton përdoren për votim. Gjatë seancës së votimit këta butona nuk mund të përdoren për rregullim të nivelit të zërit”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimet e OE ankues për njësinë digjitale të kryesuesit me mundësi votimi dhe selektor të kanaleve dhe Njësinë digjitale të delegatit me mundësi votimi dhe selektor të kanaleve, ku nga OE fitues janë ofertuar modelet VIS- DVCIC-T dhe modeli VIS-DVDIC-T, Paneli Shqyrtues konform ekspertit Shqyrtues sqaron se pas hulumtimeve të bëra nga eksperti për këtë model në përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se në raportin e ekspertit është bashkangjitur fotografia me të dhënat teknike për produktin e ofruar “VIS- DVCIC-T dhe modeli VIS-DVDIC-T” nga OE i rekomanduar. Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.

Pretendimi tjetër i OE ankues se në: “Njësinë digjitale e delegatit me selektor të kanaleve (pa mundësi votimi), është kërkuar “Të jetë i paisur me filtër të integruar të frekuencave për të ndërprerë frekuencat e ulta nga audio sinjali nëse është e nevojshme” modeli i ofruar VIS-DID-T nuk e posedon fare një filtër të tillë”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimet e OE ankues për njësinë qendrore dhe digjitale e sistemit, ku nga OE fitues është ofertuar modeli VIS-DID-T, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas hulumtimeve të bëra për këtë model nga eksperti në përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara. Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se në raportin e ekspertit është bashkangjitur fotografia me të dhënat teknike për produktin e ofruar nga OE i rekomanduar. Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues, ku pretendon që në: “Njësinë digjitale e përkthyesit simultan sipas



standardit IEC 60914, ISO 2603 dhe ISO 4043, modeli i ofertuar VIS-INT64 nuk plotëson kërkesat konform standardeve të kërkuara. Të ketë butonin dhe funksionin përsëritës (repeat) dhe të ketë funksionin e ngadalësimit (slow alert) që paralajmëron folësin të flasë më ngadalë në rast së përkthyesi nuk mund të përcjell me përkthim”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimet e OE ankues për njësinë digjitale e përkthyesit simultan sipas standardit IEC 60914, ISO 2603 dhe ISO 4043, ku nga OE fitues është ofertuar modeli VIS-INT64, Paneli Shqyrtues konform eksperti Shqyrtues sqaron se pas hulumtimeve të bëra për këtë model nga përshkrimet e bëra nga prodhuesi, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara. Edhe për këtë produkt, Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti i ka bashkangjitur modelin dhe fotografinë me të dhënat teknike. Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues, ku pretendon që në: “Kufjet për njësitë e delegatëve është kërkuar “Frekuenca e reagimit të jetë nga 20Hz deri 20kHz” ndërsa modeli i ofertuar VIS-HPD mundëson prej 80Hz deri 2kHz, dmth nuk është në kuadër të brezit frekuencor të kërkuar”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimet e OE ankues për kufjet për njësitë e delegatëve, ku nga OE fitues është ofertuar modeli i ofertuar VIS-HPD, Paneli Shqyrtues konform ekspertit sqaron se pas hulumtimeve të bëra për këtë model në përshkrimet e bëra nga prodhuesi, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara. Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues, ku pretendon që në: “Kufjet për njësitë e delegatëve është kërkuar “Frekuenca e reagimit të jetë nga 20Hz deri 20kHz” ndërsa modeli i ofertuar VIS-HPD mundëson prej 80Hz deri 2kHz, dmth nuk është në kuadër të brezit frekuencor të kërkuar”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimet e OE ankues për kufjet për njësitë e delegatëve, ku nga OE fitues është ofertuar modeli i ofertuar VIS-HPD, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas hulumtimeve të bëra për këtë model në përshkrimet e bëra nga prodhuesi, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara. Edhe për këtë produkt, Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti ka bashkangjitur fotografinë dhe të dhënat teknike. Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.



Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues, ku pretendon që në: “Njësia digjitale e përforcimit të zërit Në listën e produkteve të OE është ofruar modeli VIS-CDA-4, amplifikator i fuqisë së zërit dhe nuk plotëson kërkesat minimale teknike të kërkuara nga AK sipas specifikave teknike të dosjes së tenderit, .... të jetë i prodhuar sipas standardit IEC 61603-7 dhe IEC60914;të ketë USB port për të mundësuar regjistrimin e zërit, të ketë ekran për kontroll të regjimit të punës dhe konfiguracionit, të ketë përkrahje për së paku dy mikrofona ajror, të ketë të integruar BNC konektor për lidhje me pajisjet infrared dhe të jetë kompatibil me njësinë qendrore të mikrofona konferencial, Të ketë së paku dy audio linja në hyrje dhe dalje dhe një RS232 port për lidhje me sistem të kontrollit”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimet e OE ankues për njësia digjitale e përforcimit të zërit, në listën e produkteve të OE është ofertuar modeli VIS-CDA-4, amplifikator i fuqisë së zërit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas hulumtimeve të bëra për këtë model në përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara. Pra, Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti ka bashkangjitur raportit të dhënat teknike me fotografi për këtë produkt. Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.

Kurse, sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues, se në: “Altoparlantë muri në formë kolone është kërkuar *“Të ketë Pension konstant 100/70V”*, modeli i ofertuar VIS-SPK-C4.3 nuk plotëson një kërkesë të tillë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimet e OE ankues për Altoparlantë muri në formë kolone është kërkuar *“Të ketë Pension konstant 100/70V”*, në listën e produkteve të OE është ofertuar modeli VIS-SPK-C4.3. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas hulumtimeve të bëra për këtë model nga përshkrimet e bëra nga prodhues të ndryshëm, konsideron se pretendimet që kanë të bëjnë me kërkesat teknike janë të bazuara, ku edhe për këtë produkt eksperti ka bashkangjitur të dhënat teknike me fotografi. Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, rezulton që ky produkt nuk i plotëson kërkesat minimale teknike të AK-së.

Sa i përket pretendimit të fundit të OE ankues, ku pretendon që në “sipas kërkesës në specifikimet teknike të kërkuara nga AK, OE i përzgjedhur për kontratë nuk ka dorëzuar specifikacion teknik, model, broshurë apo katalog dhe nuk janë paraqitur fare në listën e produkteve të ofertuara produktet tjera siç janë: Aplikacioni softuerik për votim elektronik dhe menaxhim të sistemit (pako), TV 40”, TV 50”, PC dekstop, Kabllo vazhdues të sistemit të mikrofona”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se se pretendimet që kanë të bëjnë me specifikimet teknike janë të bazuara. Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke krahasuar dhe marrë për bazë ofertën e OE, ku mungon një broshurë apo katalogë të cekura në pretendimin ankimor të OE. Andaj, OE i

rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesat specifike të dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarimeve të ekspertit dhe specifikave teknike të kontestuara nga OE ankues, vjen në përfundim se AK nuk e ka bërë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së pasi që specifikat teknike të cilat janë afruar nga modelet përkatëse nuk i plotësojnë të gjitha kriteret teknike të kërkuara nga AK sipas specifikave të dosjes së tenderit. Obligohet AK që gjatë rivlerësimit të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së nëse është e nevojshme që të sqarojë dhe të plotësojë informacione shtesë lidhur me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë. Andaj, obligohet AK që të bëjë ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK Kuvendi Komunal Malishevë;
- 1x1 OE "TETRONIKS LLC"- Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.